



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2015 – Numri: 98

Tiranë – E hënë, 15 qershor 2015

PËRMBAJTJA

	Faqe
Dekret i Presidentit nr. 9123, datë 29.5.2015	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 5061
Dekret i Presidentit nr. 9124, datë 29.5.2015	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 5061
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 468, datë 3.6.2015	Për kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Radio-Televizioni Shqiptar tek Autoriteti i Mediave Audiovizive, të katit përdhës, katit të parë dhe të dytë të godinës me emërtimin “Atelier për dekorin e Radio-Televizionit”..... 5061
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 469, datë 3.6.2015	Për përcaktimin e vlerës minimale të çmimit të referencave të qirave të ndërtesave për qëllime tatimore..... 5071
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 470, datë 3.6.2015	Për një shtesë në vendimin nr. 418, datë 27.6.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të njëjësive të qeverisjes qendrore”, të ndryshuar..... 5072
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 471, datë 3.6.2015	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 151, datë 25.4.2002, të Këshillit të Ministrave, “Për statusin “Dëshmor i Atdheut””, të ndryshuar..... 5073
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 472, datë 3.6.2015	Për miratimin e raportit të monitorimit të ndihmës shtetërore për vitin 2014..... 5074
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 473, datë 3.6.2015	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 276, datë 1.4.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për dhënien në përdorim të përkohshëm, nga Ministria e Mbrojtjes Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe sipërmarrjes dhe ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, të pronës nr.33, me emërtim “Shtëpia e Ushtarakëve”, me vendndodhje në bulevardin “Zhan D’Ark”, Tiranë, për vendosjen e Qendrës Kombëtare të Regjistrimit (QKR), Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe Qendrës së Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA)”..... 5083

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 475, datë 3.6.2015	Për disa ndryshime në vendimin nr. 310, datë 5.5.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për mënyrën dhe llogaritjen e afateve të pagimit të çmimit të truallit, për kalimin e së drejtës së pronësisë mbi truallin shtetëror, në zonat me përparësi turizmin”.....	5087
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 476, datë 3.6.2015	Për miratimin, në parim, të marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar 2011 për projektin “Eficienca energjetike-programi për sektorin e transmetimit të energjisë elektrike”.....	5088
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 477, datë 3.6.2015	Për miratimin e marrëveshjes shtesë të koncesionit “Për disa ndryshime në marrëveshjen e koncesionit të formës “BOO”, ndërmjet Ministrisë së Industrisë dhe Energjetikës dhe Shoqërisë “Teodori”, sh.p.k., Tiranë, për ndërtimin e hidrocentraleve në Tërnovë dhe në Zall të Bulqizës”, miratuar me vendimin nr. 556, datë 1.8.2003, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar.....	5089
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 478, datë 3.6.2015	Për një ndryshim në vendimin nr. 1086, datë 14.12.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e task-forcës për përmirësimin e nivelit të arkëtimeve dhe uljen e nivelit të humbjeve në sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike”.....	5093
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 479, datë 3.6.2015	Për financimin e Urdhrit të Stomatologut të Republikës së Shqipërisë për një periudhë njëvjeçare.....	5093
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 481, datë 3.6.2015	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Kalimash -Morinë”(shtesat).....	5093

**DEKRET****Nr. 9123, datë 29.5.2015****PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të nenit 15 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar dhe në kërkesën e Ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:**Neni 1**

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Etleva Ziso Hajdaraj (Taka)
2. Sabina Gafur Hajdaraj
3. Nikola Jovan Martinović (Shuto)
4. Astrit Dedë Dedndreaj
5. Jorgo Vido Ajković (Alkaj)
6. Vjoleta Jovan Ajković (Davidović)
7. Esmeralda Xhavit Rama
8. Thoma Spiro Risto
9. Alma Bari Risto (Misliu)
10. Gessi Thoma Risto
11. Argita Ibrahim Kuçi
12. Edi Vojo Memeli
13. Namik Nazmi Balliu
14. Resi Selami Baxhaja

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË
Bujar Nishani**

DEKRET**Nr. 9124, datë 29.05.2015****PËR LEJIMIN E LËNIES SË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të nenit 15 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar dhe në kërkesën e Ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:**Neni 1**

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Agim Kadri Basha
2. Marina Gëzim Qyqja (Shosha)
3. Blerina Bashkim Jonuzi
4. Bledar Seit Zerelli
5. Alma Shefqet Muja (Dishi)
6. Angela Aleksandër Sema
7. Alvana Ndriçim Simbrunner (Allaj)
8. Bozho Gjuro Matanović (Matanaj)
9. Ruzhe Andro Matanović (Brojaj)
10. Branimir Spiro Krstović (Nikollaj)
11. Artur Slobodan Mikuliq
12. Jelena Millovan Krstović (Felçiq)
13. Zdravko Vladimir Zlatičanin (Kerstoja)
14. Ana Bozho Zlatičanin (Matanović)
15. Kozeta Gafurr Nurja (Zhgjuni)
16. Denis Osman Kujtim Nurja
17. Dejzi Kujtim Nurja
18. Qemal Ramadan Drini
19. Ardjan Sytki Bushati
20. Valbona Veli Bushati (Beçaj)
21. Daniel Ardjan Bushati

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË
Bujar Nishani**

VENDIM**Nr. 468, datë 3.6.2015**

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI, NGA RADIO
TELEVIZIONI SHQIPTAR TEK
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE,
TË KATIT PËRDHES, KATIT TË PARË
DHE TË DYTË TË GODINËS ME
EMËRTIMIN “ATELIER PËR DEKORIN
E RADIO-TELEVIZIONIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10, 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave



VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Radio-Televizioni Shqiptar tek Autoriteti i Mediave Audiovizive, të katit përdhes, katit të parë dhe të dytë të godinës, me emërtimin “Atelier për dekorin e Radio-Televizionit”, me adresë: rruga “Lekë Dukagjini”, zona kadastrale 8160, numri i pasurisë 2/94, Tiranë, sipas formularit dhe planimetrisë që i bashkëlidhen këtij vendimi, për t’u përdorur për mjedise pune për nevojat e këtij institucioni.

2. Autoritetit të Mediave Audiovizive i ndalohej ta tjetërsojë pronën e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, apo t’ua japë në përdorim të tretëve.

3. Autoritetit të Mediave Audiovizive i hiqet përgjegjësia e administrimit të katit të katërt dhe të pestë, si dhe të oborrit të brendshëm të ish-godinës

së hotel “Drini” në rrugën “Abdi Toptani”, në Tiranë, sipas kartelës së pasurisë nr. 1/468 dhe hartës treguese të saj, bashkëlidhur këtij vendimi, në të cilin është sistemuar me ambiente pune, në bazë të urdhrit nr. 67, datë 3.3.2000, të Kryeministrit.

4. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme, Autoriteti i Mediave Audiovizive, Radio Televizioni Shqiptar si dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

REPUBLIKA E SHQIPËRISË				
ZYRA E REGJISTRIMIT TE PASURISË SË PALUAJTSHME				
ÇERTIFIKATË			073042	
PËR VËRTETIM PRONËSIE				
Zyra e Regjistrimit	TIRANË		Zona Kadastrale Nr.	8160
Numri i Pasurisë	2/94		Volumi	24 Faqe 185
Adresa e Pasurisë	RR "LEKË DUKAGJINI"			
Lloji i Pasurisë	TRUAJL			
Sipërfaqja Totale	10177 M ²			
Nga kjo : Sa Truall	10177 M ²		Nga kjo : Sa Ndërtesa	6202
Nqs pallat :	Kuota e pjesëmarrjes		%	
KJO ÇERTIFIKATË LËSHOHET PËR TË VËRTETUAR QË				
Zoti (Zotërinjtë)				
Emri	Atësia	Mbiemri	Pjesa	Adresa
RADIO TELEVISIONI			T	TIRANË
SHQIPTAR				
- është pronar i PASURISË ME NR 2/94				
- janë bashkëpronarë sipas pjeseve më lart				
- është përfaqësues i familjes e cila ka në pronësi				
- kufizimet e pasurisë janë : V 2/93 , L 2/98				
Kjo çertifikatë plotësohet në përputhje me Ligjin e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.				
Data e lëshimit të çertifikatës				
15/01/08				
Kjo çertifikatë lëshohet sipas kërkesës së paraqitur nga i (të) interesuari (t) me datë 15/09/07 Nr. 432				
Lëshuesi i çertifikatës REGJISTRUESI				
(FADIL KALOSH)				



SEKSIONI I IDENTIFIKIMIT TË PASURISË

→ Vizon nga: Vol. _____, Fq. _____

Zona Kadastrale: 8/60 NR. i PASURISË: 2/94 Vizon në: Vol. _____, Fq. _____ deri në: Vol. _____, Fq. _____ →

Indeksi i Hartës: TR-R-12 PËRFUNDIMTARE (data) 28/09/2004

Adresa e pasurisë: Rrethi TIRANË Q/F TIRANË

Rr/L LETO BUKAGJINI P/G _____ Sh _____ K _____ Ap _____

B - SEKSIONI I PËRSHKRIMIT TË PASURISË

Lloji i Pasurisë: TRUALL Brenda V.K.N. : Jo --> (Po) Ref: PL-RREG

Sip. Totale e Pasurisë	Nga Sip. Totale: Sa Truall	Nga Sip. Truall: sa Ndërtesë	Per pjesën e përbashkët:
1. <u>10147</u> m ² Ref <u>LN2004</u>	1. <u>10147</u> m ² Ref <u>LN2004</u>	1. <u>6202</u> m ² Ref <u>LN2004</u>	<u>PALLAT</u>
2. _____ m ² Ref _____	2. _____ m ² Ref _____	2. _____ m ² Ref _____	Kuotat e Pjesëmarrjes: _____ %
3. _____ m ² Ref _____	3. _____ m ² Ref _____	3. _____ m ² Ref _____	Nr. i Pasurisë (Pallat): _____
4. _____ m ² Ref _____	4. _____ m ² Ref _____	4. _____ m ² Ref _____	Vol. _____ Fq. _____

Përshkrim i Veçantë

(Circular stamp: REPUBLIKA E ALBANIJE, QENDRA E REGJISTRIT, TIRANE, and a signature)

C - SEKSIONI I PRONËSISË

Nr. Dok	Data Regjistrim	Emri Atësis Mbiemri	Nr. Pasap	I/F/B	Adresa e Pronarit	Shuma e Paguar	Data e Lësh. Certifikates	Shënime	Firma
08509	15.01.08	RAMIOTEL VIZIONI SHQIPTAR		I	TIRANË		15.01.08 075 042	Udhëzimi Nr 467 18.12.03	<i>(Signature)</i>



**D - SEKSIONI I QIRAVE, NË PËRDORIM, MARRËVESHJEVE KUFIZUESE,
SERVITUTAVE DHE INTERESAVE TË TJERA**

Nr. Dok	Data e Regjistrimit	Tipi	Përshkrimi	Data e Lësh. të Certifikatës	Shënime	Firma

E- SEKSIONI I HIPOTEKAVE, VENDIMEVE TË GJYKATËS, KUFIZIMEVE, etj

Nr. Dok	Data e Regjistrimit	Tipi	Përshkrimi	Data e Lësh. të Certifikatës	Shënime	Firma



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
ZYRA QËNDRORE E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME
ZYRA VENDORE E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME TIRANË
 Adresa: RR: "Jordan Misja"

Tiranë, më 17.01.2008

SHËNIM: Kjo kopje kartele në A4, ka fuqi të njëjtë me origjinalin e ndodhur në zyrën tonë.
Në Regjistrin Vol 24, Faqe 186, Zona Kadastrale 8160, Qyteti Tiranë.

K. Haxhi
dh. 17.01.2008

FADIL KALOSHI



HARTA TREGUESE E REGJISTRIMIT
(Fragment)

**ZYRA E REGJISTRIMIT
TE PASURIVE TE PALUAJSHME
TIRANE**
REGJISTRUESI
FADIL KALOSH

A. IDENTIFIKIMI I PASURISE
ZONA KADASTRALE 8/60 NR. I PASURISE _____ Vol. _____ Fq. _____
INDEKSI I HARTES 72-R-12 SHKALLA 1:500
ADRESA E PASURISE: Rrethi TIRANE Q/F TIRANE
Rr/L L. DUKAGJIN P/G _____ Sh _____ K _____ Ap _____


B. KUFIZIMET **C. PRONARI/ET**
V. 2/93 2.7.54.
L. 2/98
J. 2/92: 2/100
P. 2/96: 2/97
D. Data: 1/1, Ora: _____


RR. "LEK DUKAGJIN"


2/96

2/95












PRERJA A-A

SH. 1-100



R - DRITARE.

COPE	VEREJTIJE
32	—
10	—
2	NE POROSI
2	—

00111 ATELIER PER DENO-
RUNE RADIO-TELEVISIONI.
PROJEKTION
PLANIMETRI, PRETZE
19-VI-1975
A.2
RADIO-TELEVISIONI

E. VERA B. GARY
SA. PENSACOLA

E. VERA W. JONES
Z. HONN K. BROWN

SARATOGA



VENDIM
Nr. 469, datë 3.6.2015

**PËR PËRCAKTIMIN E VLERËS
MINIMALE TË ÇMIMIT TË
REFERENCAVE TË QIRAVE TË
NDËRTESAVE PËR QËLLIME
TATIMORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “ç”, të pikës 1, të nenit 72, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Vlera e dhënies me qira të ndërtesës përcaktohet në kontratën e noterizuar të qirasë, sipas legjislacionit të fushës. Në kontratë, veç të tjerave, duhet, detyrimisht, të përcaktohet qartë adresa ku ndodhet ndërtesa, sipërfaqja, në metër katror, dhe vlera mujore e qirasë së objektit.

2. Në asnjë rast, vlera e dhënies me qira të ndërtesës, sipas pikës 1, të këtij vendimi, nuk do të jetë më e vogël se vlera minimale e qirasë, e përcaktuar në këtë vendim. Vlera minimale mujore, për metër katror sipërfaqe ndërtese të dhënë me qira, është e barabartë me 0.3 për qind të çmimit të shitjes së saj, e përcaktuar në udhëzimin e Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave, nga Enti Kombëtar i Banesave”, që miratohet çdo vit. Shembujt e zbatimit të këtij vendimi pasqyrohen në aneksin nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Për dhënien me qira të ndërtesave që nuk janë apartamente banimi, në qytetin e Tiranës, vlera minimale e qirasë mujore, për 1 m² sipërfaqe ndërtimi, përcaktohet, si më poshtë vijon:

a) Për 1m² sipërfaqe për dyqan mallrash apo shërbimesh, vlera minimale e qirasë mujore është 2 (dy) herë më e lartë se vlera minimale e qirasë mujore për 1m² sipërfaqe të apartamenteve të banimit, sipas zonave të Tiranës;

b) Për 1m² sipërfaqe për garazh të mbuluar, vlera minimale e qirasë mujore është 70 për qind e vlerës minimale të qirasë mujore për 1m² sipërfaqe të apartamenteve të banimit, sipas zonave të Tiranës;

c) Për 1m² sipërfaqe për zyrë dhe magazinë, vlera minimale e qirasë mujore është e barabartë me vlerën minimale të qirasë mujore për 1m² sipërfaqe të apartamenteve të banimit, sipas zonave të Tiranës;

ç) Për 1m² sipërfaqe parkim të hapur, vlera minimale e qirasë mujore është 30 për qind e vlerës minimale të qirasë mujore për 1m² sipërfaqe të apartamenteve të banimit, sipas zonave të Tiranës;

Për 1m² sipërfaqe bodrumi, vlera minimale e qirasë mujore është 70 për qind e vlerës minimale të qirasë mujore për 1m² sipërfaqe të apartamenteve të banimit, sipas zonave të Tiranës;

dh) Për 1m² sipërfaqe të ndërtesave të privatizuara me ligjin nr. 7652, datë 23.12.1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore”, të ndryshuar, vlera minimale e qirasë mujore është 70 për qind e vlerës minimale të qirasë mujore për 1m² sipërfaqe të apartamenteve të banimit, sipas zonave të Tiranës.

4. Për dhënien me qira të ndërtesave që nuk janë apartamente banimi, në qytete të tjera, vlera minimale e qirasë mujore, për 1m² sipërfaqe ndërtimi, përcaktohet, si më poshtë vijon:

a) Për 1m² sipërfaqe për dyqan mallrash apo shërbimesh, vlera minimale e qirasë mujore është 1.5 (një pikë pesë) herë më e lartë se vlera minimale e qirasë mujore për 1m² sipërfaqe të apartamenteve të banimit;

b) Për 1m² sipërfaqe për garazh të mbuluar, vlera minimale e qirasë mujore është 70 për qind e vlerës minimale të qirasë mujore për 1m² sipërfaqe të apartamenteve të banimit;

c) Për 1m² sipërfaqe për zyrë dhe magazinë, vlera minimale e qirasë mujore është e barabartë me vlerën minimale të qirasë mujore për 1m² sipërfaqe të apartamenteve të banimit;

ç) Për 1m² sipërfaqe parkim të hapur, vlera minimale e qirasë mujore është 30 për qind e vlerës minimale të qirasë mujore për 1m² sipërfaqe të apartamenteve të banimit;

d) Për 1m² sipërfaqe për bodrum, vlera minimale e qirasë mujore është 70 për qind e vlerës minimale të qirasë mujore për 1m² sipërfaqe të apartamenteve të banimit;

dh) Për 1m² sipërfaqe të ndërtesave të privatizuara me ligjin nr. 7652, datë 23.12.1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore”, të



ndryshuar, vlera minimale e qirasë mujore është 70 për qind e vlerës minimale të qirasë mujore për 1m² sipërfaqe të apartamenteve të banimit.

5. Noterët të dërgojnë në Drejtoritë Rajonale Tatimore përkatëse, brenda datës 15 korrik 2015, listën e kontratave të qirave në fuqi, të lidhura ndërmjet personave të ndryshëm, pavarësisht nga statusi i tyre. Në vijim, lista e kontratave të qirasë, të lidhura gjatë çdo muaji, të dërgohet nga zyrat e noterive, brenda datës 5, të muajit pasardhës, në Drejtoritë Rajonale Tatimore përkatëse. Në çdo rast, lista e kontratave të qirave të përmbajë numrin e kontratës së lidhur, datën e lidhjes, emrin e qiradhënësit dhe numrin e tij të identifikimit, emrin e qiramarrësit dhe numrin e tij të identifikimit, vlerën mujore të qirasë dhe afatin e kontratës.

6. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

ANEKSI NR. 1

Shembulli 1

Supozojmë se çmimi i shitjes/metër katror të një apartamenti banimi në qytetin e Tiranës është 190 000 (njëqind e nëntëdhjetë mijë) lekë dhe sipërfaqja e këtij apartamenti është 70 m².

Vlera minimale e qirasë mujore, për çdo metër katror, në këtë rast, është:

$$190\,000 \times 0.3\% = 570 \text{ lekë për metër katror.}$$

Vlera minimale e qirasë mujore, për këtë apartament të dhënë me qira, është:

$$70 \text{ m}^2 \times 570 \text{ lekë për metër katror} = 39\,900 \text{ lekë}$$

Shembulli 2

Supozojmë se çmimi i shitjes/metër katror të një apartamenti banimi në periferi të qytetit të Tiranës është 81 000 (tetëdhjetë e një mijë) lekë dhe sipërfaqja e këtij apartamenti është 70 m².

Tabela

Institucioni Buxhetor	Emertesa e Bordit/Keshilli	Numri maksimal i pagesave ne nje vit	Nr. i Anëtarëve	Shpërblim anëtari (Lekë)
Ministria e Arsimit dhe Sportit	Këshilli Kombëtar i Arsimit Parauniversitar	6	6	13.000

Vlera minimale e qirasë mujore, për çdo metër katror të këtij apartamenti, është:

$$81\,000 \times 0.3\% = 243 \text{ lekë për metër katror.}$$

Vlera minimale e qirasë mujore, për këtë apartament të dhënë me qira, është:

$$70 \text{ m}^2 \times 243 \text{ lekë për metër katror} = 17\,010 \text{ lekë.}$$

VENDIM

Nr. 470, datë 3.6.2015

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 418, DATË 27.6.2012, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E MASËS SË SHPËRBLIMIT TË ANËTARËVE TË KËSHILLAVE, BORDEVE OSE KOMISIONEVE TË NJËSIVE TË QEVERISJES QENDRORE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe shpërblimeve”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 418, datë 27.6.2012, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhet shtesa e mëposhtme:

Në lidhjen nr. 1, të përmendur në pikën 3, në emërtesën e institucionit “Ministria e Arsimit dhe Sportit”, pas emërtesës “Këshilli Kombëtar i Sportit” shtohet “Këshilli Kombëtar i Arsimit Parauniversitar”, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Sportit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

**VENDIM****Nr. 471, datë 3.6.2015**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË VENDIMIN NR. 151, DATË 25.4.2002,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
STATUSIN “DËSHMOR I ATDHEUT””,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 112, të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999, “Kodi i Procedurave Administrative”, të ndryshuar, dhe të neneve 4, 13 e 20, të ligjit nr. 8607, datë 27.4.2000, “Statusi i Dëshmorit të Atdheut”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 151, datë 25.4.2002, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë vijon:

1. Në pikën 1 bëhen këto ndryshime:

a) Shkronja “a” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“a) Komisioni Qendror për dhënien e statusit “Dëshmor i Atdheut” kryesohet nga ministri i Mbrojtjes dhe përbëhet nga:

- Zëvendësministri i Mbrojtjes	nënkryetar;
- Zëvendësministri i Punëve të Brendshme	anëtar;
- Zëvendësministri i Drejtësisë	anëtar;
- Zëvendësministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë	anëtar;
- Një përfaqësues i Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve të LANÇ-it	anëtar;
- Një përfaqësues i Organizatës së Veteranëve të LANÇ-ittë Popullit Shqiptar	anëtar.”.

b) Në fund të paragrafit të parë, të shkronjës “c”, fjalët “...një herë në muaj...”, zëvendësohen me fjalët “...me kërkesën e kryetarit të Komisionit Qendror për dhënien e statusit “Dëshmor i Atdheut”...”.

2. Shkronja “c”, e pikës 2, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“c) Komisioni Qendror për dhënien e statusit “Dëshmor i Atdheut” shqyrton dokumentet e dërguara nga Këshilli i Qarkut ose Prefekti dhe relacionin e stafit teknik. Komisioni Qendror merr vendimin për shpalljen ose jo “Dëshmor i

Atdheut” të të ndjerit dhe njofton të interesuarin nëpërmjet Këshillit të Qarkut ose Prefektit. Vendimi i Komisionit Qendror për mos dhënien e statusit “Dëshmor i Atdheut” duhet të jetë i arsyetuar.”.

3. Pas shkronjës “a”, në pikën 3, shtohen dy paragrafë, me këtë përmbajtje:

“Kërkesën për varrosjen ose rivarrosjen e Dëshmorit të Atdheut në kryeqytet e bën Këshilli i Qarkut ose Prefekti.

Varrimi i Dëshmorit të Atdheut në varrezat e Dëshmorëve të Atdheut në qarqe bëhet me vendim të Këshillit të Qarkut ose Prefektit.”.

4. Paragrafi i parë, i shkronjës “a”, në pikën 5, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“a) Shpërblimi financiar mujor për familjen e Dëshmorit të Atdheut caktohet në masën 7 000 (shtatë mijë) lekë. Komisioni Qendror për dhënien e statusit “Dëshmor i Atdheut” i dërgon Institutit të Sigurimeve Shoqërore emrin e familjarit që përfiton shpërblimin financiar bashkë me një kopje origjinale të vendimit për dhënien e statusit “Dëshmor i Atdheut”. Një kopje e vendimit të komisionit, në çdo rast, vendoset në dosjen përkatëse të “Dëshmorit të Atdheut.”.

5. Pas pikës 6 shtohet pika 7, me këtë përmbajtje:

“7. Trajtimi financiar për rrethin familjar të Dëshmorit të Atdheut fillon në datën e shpalljes së vendimit të Komisionit Qendror për dhënien e statusit “Dëshmor i Atdheut”.

Trajtimi financiar për rrethin familjar të Dëshmorit të Atdheut, i cili e ka fituar të drejtën për t’u njohur si Dëshmor i Atdheut me vendim gjykatë të formës së prerë, fillon nga data e vendimit të komisionit për mosdhënien e statusit “Dëshmor i Atdheut.”.

6. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare. Efektet financiare fillojnë nga data 1.1.2016.

**KRYEMINISTRI
Edi Rama**

**VENDIM****Nr. 472, datë 3.6.2015****PËR MIRATIMIN E RAPORTIT TË
MONITORIMIT TË NDIHMËS
SHTETËRORE PËR VITIN 2014**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17, shkronja “dh”, 18, shkronja “e”, dhe 32, pika 2, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e raportit të monitorimit të ndihmës shtetërore për vitin 2014, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

**RAPORTI I MONITORIMIT
TË NDIHMËS SHTETËRORE PËR VITIN
2014****1. HYRJE**

Raporti vjetor i monitorimit të ndihmës shtetërore për vitin 2014 përfshin të gjitha shpenzimet e ndihmës shtetërore në Republikën e Shqipërisë. Në zbatim të nenit 32 të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, dhënësit e ndihmës detyrohen që, brenda datës 31 mars, të çdo viti, të paraqesin pranë Drejtorisë së Tregut të Brendshëm raportin e zbatimit për të gjitha skemat e ndihmës shtetërore dhe ndihmat individuale të dhëna gjatë vitit paraardhës financiar.

Mbi bazën e tyre përgatitet Raporti Vjetor i Ndhimave Shtetërore, i cili miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave. Të dhënat e përfshira në këtë raport janë raportuar nga dhënës të ndihmës shtetërore, si: Ministria e Financave (MF), Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (MZHETTS), Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës (Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës-Kanalizimeve), Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë (Shërbimi Kombëtar i Punësimit), Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) dhe Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA).

Faqe | 5074

Shpenzimet e ndihmës shtetërore lidhen me të gjitha masat ekzistuese të ndihmës për sektorin e prodhimit, të shërbimeve, bujqësinë dhe peshkimin dhe skemat e reja të ndihmës shtetërore, të miratuara nga Komisioni i Ndhimës Shtetërore gjatë vitit 2014. Në hartimin e raportit të tetë vjetor, për ndihmat shtetërore, struktura e raportimit të ndihmës shtetërore është bazuar në aneksin III, të rregullores, “Për procedurat dhe formën e njoftimit”¹ si dhe në metodologjinë e Komisionit Evropian². Në këtë mënyrë, në raport jepet informacion për shumën e ndihmës shtetërore në BE dhe shtetet anëtare.

Në Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit me Bashkimin Evropian, neni 71, pika 5, parashikohet se vendi ynë duhet të garantojë transparencë në fushën e ndihmës shtetërore, duke paraqitur raportin vjetor dhe duke ndjekur metodologjinë e Komisionit Evropian për ndihmën shtetërore. Për këtë arsye, ligji nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, ngarkon strukturat e ndihmës shtetërore³ për përgatitjen e këtij raporti, duke plotësuar një detyrim ligjor dhe duke shënuar një hap përpara në drejtim të angazhimeve që ka ndërmarrë vendi ynë në fushën e ndihmës shtetërore në kuadër të procesit të integritetit në BE.

Sipas metodologjisë, ndihma shtetërore klasifikohet në dy grupe kryesore:

1. Ndhimë shtetërore për bujqësinë dhe peshkimin; dhe
2. Ndhimë shtetërore për industrinë dhe shërbimet.

Ndhimë shtetërore për industrinë dhe shërbimet përfshin kategorinë e ndihmës horizontale dhe ndihmës sektoriale.

Ndhimë shtetërore horizontale përfshin:

- Ndhimën për kërkim-zhvillim dhe inovacion;
- Ndhimën për mbrojtjen e mjedisit;
- Ndhimën për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme;

- Ndhimën për punësim;
- Ndhimën për trajnim;
- Ndhimën operacionale;

¹ VKM nr. 817, datë 28.12.2005, “Për miratimin e rregullores për procedurat dhe formën e njoftimit”.

² Ligji nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar

³ Neni 17 “Detyrat dhe përgjegjësitë e komisionit”, shkronja “f”, dhe neni 18, shkronja “g” “Përgatit raportin vjetor”.



- Ndhimën për sportin.

Ndihma shtetërore sektoriale përfshin:

- Ndhimën për transportin publik;
- Ndhimën për shërbimet publike;
- Ndhimën për minierat;
- Ndhimën për energjinë.

Ndihma shtetërore jepet duke përdorur disa instrumente, si:

A1 - Subvencione dhe grante;

A2 - Përfshirja nga taksat, shtyrja e taksave, ulja e

normës së taksave dhe zbritje e kontributit në sigurimet sociale;

B - Pjesëmarrja në kapital;

C1 - Hua të buta;

C2 - Instrumente të tjera;

D - Garancitë.

2. NDIHMA SHETETËRORE NË VITIN 2014

2.1 Ndhima shtetërore krahasuar me treguesit kryesore makroekonomike

Tabela nr.1: Ndhima shtetërore krahasuar me disa nga treguesit makro

Treguesit	Njësia e matjes	2011	2012	2013	2014
Ndihma Shtetërore	mln euro	117,52	154,56	143,85	46,41
PBB	mln euro	9.125,07	9.540,94	9.681,00	10.092,00
Ndihma Shtetërore/PBB	%	1,29	1,62	1,49	0,44
Shpenzimet nga buxheti i shtetit	mln euro	2,679	2,707	2,919	3,257
Ndihma shtetërore/Shpenzimet buxheti i shtetit	%	4,4	5,7	4,93	1,37
Të punësuar	mijë	1.161	1.117	983	1.067
Ndihma shtetërore për çdo të punësuar	euro	101	138	146	42
Popullsia	milion	2,84	2,82	2,89	2,89
Ndihma Shtetërore për frymë	euro	41	55	50	16

Burimi: MF, INSTAT dhe MZHEHTS


Tabela nr. 1 paraqet të dhënat për ndihmën shtetërore gjithsej të dhënë në Shqipëri në periudhën 2011-2014, të krahasuara me disa nga treguesit bazë makroekonomikë. Ndhima shtetërore në vlerë absolute e dhënë në vitin 2014 ka zbritur me 70 % e krahasuar me vitin 2013 dhe vitin 2012. Peshja e ndihmës shtetërore ndaj PBB-së zbriti nga 1.62 % në 2012, në 1.49 % në vitin 2013 dhe në 0.44 % në vitin 2014.

Ndihma shtetërore përfshirë sektorin e bujqësisë dhe peshkimit në vitin 2014 është dhënë në vlerën totale prej 6. 503, 12 mln lekë (46,41 mln euro).

Ndihma shtetërore, përjashtuar sektorin e bujqësisë dhe peshkimit në vitin 2014, është dhënë në vlerën totale prej 5.332,3 mln lekë (38 mln euro).

Raporti vjetor përmban të dhëna për periudhën 2011-2014, por grafiku nr. 1 paraqet ecurinë e ndihmës shtetërore në Shqipëri nga viti 2005 e në vazhdim, periudhë për të cilën janë raportuar të dhënat e ndihmës shtetërore.

Grafiku nr. 1: Ecuria e ndihmës shtetërore në raport me PBB 2005 –2014





2.2 Ndhimja shtetërore në Shqipëri e krahasuar me shtetet anëtare të BE-së

Tabela nr. 2: Ndhimja shtetërore 2012-2013*Burimi: Komisioni Evropian, DG Competition⁴ dhe MZHETTS*

Shtetet	2012		2013	
	mln euro	% PBB	mln euro	% PBB
Shqipëria	154,56	1,59	143,85	1,45
EU (28 countries)	66.739,70	0,50	62.736,90	0,50
Belgium	1.510,20	0,40	1.466,40	0,40
Bulgaria	76,40	0,20	120,70	0,30
Czech Republic	1.501,40	1,00	1.658,10	1,10
Denmark	2.564,50	1,00	2.526,00	1,00
Germany	11.999,00	0,40	12.017,60	0,40
Estonia	61,20	0,30	63,00	0,30
Ireland	844,90	0,50	797,20	0,50
Greece	1.913,10	1,00	2.919,70	1,60
Spain	3.887,40	0,40	2.779,20	0,30
France	15.177,90	0,70	12.988,80	0,60
Croatia	:	:	170,10	0,40
Italy	4.471,00	0,30	3.520,40	0,20
Cyprus	117,00	0,70	104,20	0,60
Latvia	358,40	1,10	373,60	1,10
Lithuania	228,00	0,70	205,30	0,60
Luxembourg	101,40	0,20	158,10	0,30
Hungary	1.205,80	1,20	1.524,00	1,60
Malta	106,60	1,50	129,30	1,80
Netherlands	2.472,70	0,40	2.006,70	0,30
Austria	1.882,70	0,60	1.816,30	0,60
Poland	2.965,00	0,80	2.671,00	0,70
Portugal	1.033,70	0,60	543,00	0,30
Romania	868,80	0,60	879,20	0,60
Slovenia	453,80	1,30	579,10	1,60
Slovakia	133,10	0,20	198,90	0,30
Finland	2.466,50	1,30	2.545,70	1,30
Sweden	3.282,60	0,80	3.367,40	0,80
United Kingdom	5.056,40	0,30	4.607,70	0,20

⁴ http://ec.europa.eu/competition/state_aid/scoreboard/index_en.html



Tabela nr. 2 paraqet informacion për ndihmën shtetërore në Shqipëri dhe 28 shtetet anëtare të Bashkimit Evropian për vitin 2012 dhe 2013. Në tabelë janë përfshirë të dhënat e publikuara nga Komisioni Evropian në vitin 2013 për ndihmën shtetërore duke përfshirë ndihmën që kanë dhënë shtetet anëtare për përballimin e krizës ekonomike dhe transportin.

Ndihma përfshin shpenzimet që ka kryer çdo shtet anëtar, i cili është orientuar për realizimin e objektivave horizontale me interes të përbashkët, ndihmën e dhënë për sektorët të ndryshëm të ekonomisë, si p.sh. bujqësia, peshkimi, transporti, si edhe ndihmën për arritjen e objektivave të veçantë, si p.sh. shpëtim dhe ristrukturim, ndihmën për mbylljen e

ndërmarrjeve, duke përfshirë ndihmën për sektorin e hekurudhave.

2.3 Kategoritë e ndihmës shtetërore

Sipas metodologjisë së Bashkimit Evropian, ndihma shtetërore ndahet në dy kategori:

- Ndihmë shtetërore horizontale, dhe
- Ndihmë shtetërore sektoriale.

Ndihma shtetërore horizontale jepet për një numër të madh përfituesish, pa dhënë preferenca për ndonjë aktivitet ekonomike, ndërmarrje ekonomike, produkt apo shërbim, duke minimizuar efektet në konkurrencë.

Ndihma shtetërore sektoriale jepet për aktivitete dhe sektorë të veçantë, duke pasur një ndikim më të madh në konkurrencën në treg.

Tabela nr. 3: Ndihma shtetërore gjithsej 2011- 2014 ndarë sipas kategorive


(përfshirë bujqësinë dhe peshkimin-vlerat në mln lekë)

Burimi: Drejtoria e Tregut të Brendshëm, MZHETTS

KATEGORIA	2011		2012		2013		2014	
	mln lekë	në %	mln lekë	në %	mln lekë	në %	mln lekë	në %
Bujqësia	2.167,58	13,10	2.163,85	10,07	1.156,90	5,73	1.170,82	18,00
Ndihma Horizontale	11.982,85	72,42	16.805,53	78,24	17.881,62	88,62	4.217,05	64,85
<i>Punësimi</i>	37,25	0,23	23,30	0,11	21,10	0,10	150,08	2,31
<i>Trajnim</i>	62,30	0,38	64,80	0,30	63,10	0,31	109,84	1,69
<i>Mjedisi</i>	-	-	-	-	-	-	-	-
<i>Eksporti</i>	-	-	-	-	-	-	-	-
<i>Ndihma operacionale</i>	2.483,52	15,01	2.205,33	10,27	1.160,12	5,75	1.247,99	19,19
<i>Shpëtim dhe ristrukturim</i>	-	-	-	-	-	-	-	-
<i>Kërkim, zhvillim dhe inovacion</i>	9.399,78	56,81	14.504,00	67,52	16.629,32	82,41	2.027,68	31,18
<i>SME</i>	-	-	8,10	0,04	7,98	0,04	37,46	0,58
<i>të tjera</i>	-	-	-	-	-	-	644,00	9,90
Ndihma Sektoriale	2.394,86	14,47	2.511,39	11,69	1.139,61	5,65	1.115,25	17,15
<i>Transport publik (Hekurudha)</i>	452,00	2,73	440,00	2,05	440,00	2,18	440,00	6,77
<i>Shërbimi publik</i>	773,00	4,67	787,00	3,66	600,00	2,97	450,00	6,92
<i>Minierat</i>	5,00	0,03	13,00	0,06	13,90	0,07	30,00	0,46
<i>Energjia</i>	1.161,97	7,02	1.268,50	5,91	85,71	0,42	195,25	3,00
<i>Turizmi</i>	-	-	-	-	-	-	-	-
<i>të tjera</i>	2,89	0,02	2,89	0,01	-	-	-	-
TOTALI	16.545,29	100	21.480,77	100	20.178,13	100	6.503,12	100



Grafiku nr. 2: Ndhimja shtetërore sipas kategorive



Të dhënat në tabelën 3 dhe të paraqitura në grafikun 2, tregojnë se në vitin 2014 ndihma horizontale vazhdon të zërë pjesën më të madhe të ndihmës shtetërore gjithsej me 65 %, ndërsa kategoria e ndihmave sektoriale përbën 17 %.

2.3.1. Ndhimja shtetërore horizontale


Në vitin 2014 ndihma shtetërore horizontale në vlerë absolute është 4.217,05 mln lekë (30,1 mln euro) dhe e krahasuar me vitin 2013 ka zbritur me 76 %. Pesha për këtë kategori në totalin e ndihmës në vitin 2014 ka zbritur me 24 % krahasuar me vitin 2013.

Tabela nr. 4: Ndhimja shtetërore horizontale 2012- 2014 (mln lekë/mln euro)


Burimi: Drejtoria e Tregut të Brendshëm, MZHETTS


Ndhimja Horizontale	2012		2013		2014		ndryshimi 2013/2012	ndryshimi 2014/2013
	mln LEK	mln EUR	mln LEK	mln EUR	mln LEK	mln EUR		
<i>kursi mes. i këmbimit</i>		139,04		140,27		140,11		
Punësimi	23,30	0,17	21,07	0,15	150,08	1,07	90,41	712,46
Kultura	-	-	-	-	-	-	-	-
Mjedis	-	-	-	-	-	-	-	-
Eksporti	-	-	-	-	-	-	-	-
Ndhimja operacionale	2.205,33	15,86	1.160,10	8,27	1.247,99	8,91	52,60	107,58
Shpëtim dhe Ristrukturim	-	-	-	-	-	-	-	-
Kërkim dhe Zhvillim	14.504,00	104,32	16.629,32	118,55	2.027,68	14,47	114,65	12,19
SME-të	8,10	0,06	7,98	0,06	37,46	0,27	98,52	469,42
Sporti	-	-	-	-	644,00	4,60	-	-
Trajnimi	64,80	0,47	63,10	0,45	109,84	0,78	97,38	174,07
Total	16.805,53	120,87	17.881,57	127,48	4.217,05	30,10	106,40	23,58

Grafiku nr. 4: Ecuria e ndihmës shtetërore horizontale (mln euro)



Grafiku nr. 5 dhe 6: Struktura e ndihmës shtetërore horizontale në vitet 2011-2013





Nga grafikët e mësipërm vërehet se ndihma horizontale gjatë vitit 2014 ka pësuar një rënie të konsiderueshme krahasuar me vitet e mëparshme. Nga 17.881, mln lekë në fund të vitit 2013, ka zbritur në 4.217,05 mln lekë në vitin 2014. Rënia i atribuohet zvogëlimit të ndihmës për kërkim dhe zhvillim. Gjithsesi, vlen të theksohet që brenda kategorisë së ndihmës horizontale është rritur ndjeshëm ndihma për SME-të, ndihma për punësim dhe ndihma për trajnim, duke përmirësuar më tej strukturën ndihmës horizontale dhe arritjen e qëllimit për të cilin jepet ndihma shtetërore.

Ndihma për kërkim dhe zhvillim. Gjatë vitit 2014 është vlerësuar se kjo ndihmë vazhdon të zërë pjesën më të rëndësishme në kategorinë e ndihmës horizontale. Sipas raportimit të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN), ndihma shtetërore për kërkim dhe zhvillim është dhënë për ndërmarrjet që nënshkruajnë “marrëveshje hidrokarburesh” dhe nënkontraktuesit e tyre, duke iu ofruar një përjashtim nga detyrimet doganore për pajisjet, makineritë, materialet, si dhe një përjashtim nga tatimi mbi vlerën e shtuar të të gjithë kontraktorëve dhe nënkontraktorëve për realizimin e fazave të kërkimit dhe të zhvillimit të operacioneve hidrokarbure. Në vitin 2014, është raportuar se kompanitë e huaja që kryejnë operacione hidrokarbure në Shqipëri kanë përfituar përjashtime në import (TVSH dhe përjashtime doganore), përjashtime në akcizë dhe përjashtimi nga TVSH për shërbimet, duke arritur gjithsej në shumën 2.027,68 mln lekë (në vitin 2013 shuma e përjashtimeve ishte 16.629,32 mln lekë).

Ndihma operationale. Kjo kategori përfshin skemën e shtyrjes së pagesës së TVSH-së për

importin e makinerive dhe pajisjeve⁵, skemën e rimbursimit të akcizës së lëndëve djegëse të konsumuar në serat me ngrohje dhe industrinë⁶. Për vitin 2014 Ministria e Financave për këtë kategori raporton se nga zbatimi i skemës së shtyrjes së TVSH për importin e makinerive dhe pajisjeve kanë përfituar gjithsej 59 ndërmarrje, në shumën 769.07 mln lekë dhe se nga skema e rimbursimit të akcizës së lëndëve djegëse, të konsumuar në serat me ngrohje dhe industrinë kanë përfituar 38 ndërmarrje në shumën 478.92 mln lekë.

Ndihma për trajnim. Mbështetur në raportimin e Shërbimit Kombëtar të Punësimit (SHKP) ndihma për trajnim në vitin 2014 është rritur në krahasim me vitin 2013. Nga programi i nxitjes së punësimit të punëkërkuesve të papunë nëpërmjet formimit në punë⁷, kanë përfituar 51 ndërmarrje të vogla dhe të mesme (në vitin 2013 ishin 28 ndërmarrje përfituese), në sektorin e konfeksioneve, duke u krijuar gjithsej 1071 (në vitin 2013 u krijuan 436 vende të reja të punës).

Ndihma për punësim. Sipas të dhënave të SHKP ndihma për punësim në vitin 2014 është rritur në krahasim me vitin 2013. Nëpërmjet programit të nxitjes së punësimit të punëkërkuesve të papunë në vështirësi⁸ kanë përfituar 172 ndërmarrje të vogla dhe të mesme (në vitin 2013 ishin 8 ndërmarrje përfituese) me veprimtari ekonomike në fushën e prodhimit të këpucëve dhe konfeksione, duke u krijuar 2221 vende të reja të punës (në vitin 2013 u krijuan 282 vende të reja të punës). Në programin e nxitjes së punësimit të praktikave profesionale për punëkërkuesit që kanë mbaruar arsimin e

5 Vendim i KNSH-së nr. 17, datë 16.7.2007 Për skemën e shtyrjes së pagesës së TVSH-së makinerive dhe pajisjeve të importuara, si dhe të energjisë elektrike të importuar nga KESH sh.a.

6 Vendim i KNSH-së nr. 24, datë 2.5.2008 “Për përcaktimin e kushteve dhe procedurave për rimbursimin e akcizës së lëndëve djegëse, të konsumuar në serat me ngrohje për prodhimin e produkteve industriale dhe agroindustriale të cilat përdoren për nevojat teknologjike të prodhimit”

7 Vendimi i KNSH-së nr. 12, datë 15.3.2007 “Për skemën ekzistuese “Për programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet formimit në punë””.

8 Vendimi i KNSH-së nr. 11, datë 15.3.2007 “Për skemën ekzistuese “Për programin e nxitjes së punësimit, të punëkërkuesve të papunë””.



lartë brenda dhe jashtë vendit⁹, kanë përfituar 97 ndërmarrje të vogla dhe të mesme duke u krijuar 426 vende të reja të punës. Nga programi i nxitjes së punësimit të femrave nga grupet e veçanta¹⁰, kanë përfituar 12 ndërmarrje të vogla dhe të mesme (në vitin 2013 ishin 4 ndërmarrje përfituese) duke u krijuar 120 vende të reja të punës (në vitin 2013 u krijuan 36 vende të reja të punës). Në vitin 2014 është zbatuar për herë të parë programi i nxitjes së punësimit të punëkërkuësve të papunë të rinj¹¹, nëpërmjet së cilës kanë përfituar 21 ndërmarrje të vogla dhe të mesme në sektorin e telekomunikacionit, hotelierisë dhe konsulencës, duke i krijuar 117 vende të reja të punës. Gjithashtu gjatë vitit 2014 është zbatuar për herë të parë programi i nxitjes së punësimit të personave me aftësi të kufizuara¹², nëpërmjet së cilës kanë përfituar 8 ndërmarrje të vogla dhe të mesme në sektorin e konsulencës dhe shërbimeve, duke i krijuar 14 vende të reja të punës.

Në kategorinë e ndihmës horizontale përfshihet gjithashtu ndihma për SME-të. Dhënës i ndihmës është Drejtoria e Mbështetjes së Sipërmarrjes në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (MZHETS), ndërsa autoriteti përgjegjës për zbatimin dhe monitorimin e kësaj mase është Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA). Për vitin 2014 AIDA raporton se:

- Fondi në mbështetje të grave sipërmarrëse dhe fondi “*Start up*” nuk ka qenë funksional, sepse e funksionimit të tyre nuk u miratuan gjatë vitit 2014.

- Nga fondi shqiptar i ekonomisë kreative¹³

9 Vendim i KNSH-së nr. 13, datë 15.3.2007 “Për skemën ekzistuese “Për programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet formimit institucional””.

10 Vendimi i KNSH-së nr. 38, datë 19.9.2011 “Për planin e dhënies së ndihmës shtetërore “Për programin e nxitjes së punësimit të femrave nga grupet e veçanta””.

11 Vendim i KNSH-së nr.39, datë 19.9.2011 “Për planin e dhënies së ndihmës shtetërore “Për masën e financimit, kriteret dhe procedurat e zbatimit të programit të nxitjes së punësimit të punëkërkuësve të papunë që hyjnë për herë të parë në punë””.

12 Vendim i KNSH-së nr. 47, datë 28.3.2014 “Për planin e dhënies së ndihmës shtetërore “Për programin e nxitjes së punësimit të personave me aftësi të kufizuara””.

13 Vendim i KNSH-së nr. 45, datë 28.3.2014 “Për planin e dhënies së ndihmës shtetërore “Për krijimin e fondit të ekonomisë kreative (artizanat)””.

kanë përfituar ndihmë shtetërore gjithsej 13 ndërmarrje të vogla dhe të mesme në shumën 6.13 mln lekë. Ndihma shtetërore për këto ndërmarrje ka ndikuar në rritjen e kapaciteteve prodhuese të biznesit, zgjerimin e linjës së produkteve trendi, të cilat konsumatori i kërkon në mënyrë të vazhdueshme, si edhe rritjen e të ardhurave.

- Nga fondi i inovacionit¹⁴ kanë përfituar ndihmë shtetërore 24 ndërmarrje të vogla dhe të mesme në shumën 7.76 mln lekë. Ndërmarrjet përfituese u përkasin sektorëve të fasonit (tekstil-veshje & lëkurë-këpucëve), agrobiznes, prodhim industrial dhe tregtim materialeve elektrike dhe telekomunikacionit.

- Nga fondi shqiptar i konkurrueshmërisë¹⁵ kanë përfituar ndihmë shtetërore gjithsej 20 ndërmarrje të vogla dhe të mesme në shumën 22.57 mln lekë. Ndihma shtetërore për këto ndërmarrje ka ndikuar në rritjen e produktivitetit, përmirësimin e imazhit të ndërmarrjeve në tregun vendas dhe ndërkombëtar, rritjen e besueshmërisë të konsumatorit e produkteve/shërbimeve, si edhe forcimin e kapaciteteve manaxheriale.

Ndihma për sportin: Komisioni i Ndihmës Shtetërore¹⁶ ka autorizuar ndihmën shtetërore për rikonstruksionin e stadiumit “Elbasan Arena” (444 milionë lekë janë financuar me fonde nga buxheti i shtetit) me qëllim organizimin e ri të ambienteve të brendshme të godinës ekzistuese dhe zgjerimin e saj me pjesë të re, duke ofruar shërbimet e nevojshme për median në harmoni me kërkesat e parashtruara nga UEFA, si edhe ndërtimin e Parkut Olimpik të Tiranës (me fonde nga buxheti i shtetit në shumën 200 milionë lekë në vitin 2014 dhe diferenca e kontratës do të financohet në vitin 2015).

Komisioni autorizoi ndihmën shtetërore për

10 Vendimi i KNSH-së nr. 44 datë 11.9.2012 “Për planin e dhënies së ndihmës shtetërore “Për krijimin e fondit të inovacionit””.

15 Vendimi i KNSH-së nr.10, datë 2.2.2007 “Për planin e dhënies së ndihmës shtetërore për grantin “Për krijimin e fondit shqiptar të konkurrueshmërisë””.

16 Vendim i KNSH-së nr. 53, datë 26.1.2015 “Për skemën e ndihmës shtetërore në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 411, datë 20.6.2014 “Për bashkëfinancimin e projektit të stadiumit “Ruzhdi Bizhuta” Elbasan, dhe financimin e Parkut Olimpik të Tiranës””.



ndërtimin e stadiumit “Elbasan Arena” dhe Parkut Olimpik të Tiranës, të parashikuar në VKM nr. 411, datë 20.06.2014 “Për bashkëfinancimin e projektit të stadiumit “Ruzhdi Bizhuta” Elbasan, dhe financimin e Parkut Olimpik të Tiranës”, mbështetur në nenin 13, pika 3 të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, sepse skema mbështet realizimin e dy projekteve të rëndësishme dhe me ndikim të konsiderueshëm

në cilësinë e sportit shqiptare, si edhe lehtëson zhvillimin e veprimtarive të caktuara ekonomike.

2.3.2. Ndihma shtetërore sektoriale

Në vitin 2014 ndihma shtetërore sektoriale në vlerë absolute është 1.115,25 mln lekë (7,96 mln euro), 2 % më pak krahasuar me vitin 2013. Peshë për këtë kategori në totalin e ndihmës në vitin 2014 është rritur në 17.15 % nga 5.65 % që ishte në vitin 2013.


Tabela nr. 5: Ndihma shtetërore sektoriale 2012- 2014 (mln lekë/mln euro)

Burimi: Drejtoria e Tregut të Brendshëm, MZHETTS

Ndihma sektoriale	2012		2013		2014		ndryshimi 2013/2011	ndryshimi 2014/2013
	mln LEK	mln EUR	mln LEK	mln EUR	mln LEK	mln EUR		
<i>kursi mes. i këmbimit</i>		139,04		140,27		140,11	2	
Transporti publik	440,00	3,16	440,00	3,14	440,00	3,14	100,00	100,00
Shërbime publike	787,00	5,66	600,00	4,28	450,00	3,21	76,24	75,00
Minerat	13,00	0,09	13,90	0,10	30,00	0,21	106,92	215,83
Energjia	1.268,50	9,12	85,71	0,61	195,25	1,39	6,76	227,80
Televizionet/mediat	2,89	0,02	-	-	-	-	-	-
Turizmi	-	-	-	-	-	-	-	-
TOTAL	2.511,39	18,06	1.139,61	8,12	1.115,25	7,96	45,38	97,86

Grafiku nr. 7: Struktura e ndihmës shtetërore sektoriale 2012- 2014

Burimi: Drejtoria e Tregut të Brendshëm, MZHETTS



Në strukturën e ndihmës sektoriale (vertikale) për vitin 2014, peshën më të lartë e zë ndihma për shërbimet publike (ndihma për sektorin e ujësjellës-kanalizimeve), e ndjekur nga ndihma për transportin publik (hekurudha) dhe ndihma për minerat (në mbyllje dhe konservim). Ndihma për energjinë është dhënë në masën 195,25 milionë lekë, një ndihmë individuale që ka të bëjë me shtyrjen e pagesës së TVSH-së për

importimin e energjisë elektrike nga KESH sh.a.”¹⁷.

Për sa i takon transportit publik ndihma shtetërore është dhënë nga buxheti i shtetit për mbështetjen e transportit hekurudhor, i cili nuk ndryshon me vlerën e subvencionit të akorduar në vitin 2013.

Ndihma për shërbimet publike: Autoriteti dhënës është Ministria e Transportit dhe Infrastruktës, ndërkohë që institucioni përgjegjës është Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës Kanalizimeve (DPUK). Ndihma për shërbimet publike është në formën e subvencionit nga buxheti i shtetit¹⁸. Sipas raportimit nga DPUK, numri i përfituesve të ndihmës për vitin 2014 është 50 ndërmarrje ujësjellës-kanalizime dhe 5 sisteme ujësjellës-

17 Vendim i KNSH-së nr. 17, datë 16.7.2007 “Për skemën e shtyrjes së pagesës së TVSH-së makinerive dhe pajisjeve të importuara, si dhe të energjisë elektrike të importuar nga KESH sh.a”.

18 Vendim i KNSH-së nr. 5, datë 20.10.2006 “Për skemën ekzistuese të subvencionimit të ndërmarrjeve të ujësjellësit”.



kanalizime që administrohen nga komunat. Përfituesit kryesorë të ndihmës janë sh.a. Ujësjetllës Kanalizime në qytetet Durrës, Patos, Lezhë, Kavajë dhe sh.a. Ujësjetllës Kanalizime Elbasan Fshat.

2.4. Instrumentet e shpërndarjes së ndihmës shtetërore

Ndihma shtetërore e dhënë nga burime shtetërore, në varësi të llojit (instrumentit) të përdorur, përbën një shpenzim real apo potencial të pasurisë publike duke patur një efekt në mbledhjen e të ardhurave publike. Në vitin 2014, ndihma shtetërore është dhënë kryesisht në

formën e subvencioneve dhe lehtësirave tatimore. Referuar metodologjisë së përdorur nga BE, instrumentet e ndihmës shtetërore klasifikohen në:

A1 - Subvencione dhe grante;

A2- Përfjashtimi nga taksat, shtyrja e taksave, ulja e normës së taksave dhe zbritje e kontributit në sigurimet sociale;

B - Pjesëmarrja në kapital;

C1 - Hua të buta;

C2 - Instrumente të tjera;

D – Garancitë.


Tabela nr. 6: Ndihma shtetërore gjithsej sipas instrumenteve

Burimi: Drejtoria e Tregut të Brendshëm, MZHESTS

Kategoria e ndihmës		Subvencione dhe Grante (A1)	Përfjashtim nga taksat, shtyrja e taksave, ulja e normës së taksave dhe zbritje e kontributit në sigurimet sociale (A2)	Të tjera instrumente (C 2)	Totali
I	Ndihmat horizontale				4.217
	1 Punësimi	150,08			150,08
	2 Ndihma operacionale		1.247,99		1.247,99
	3 Kërkimi dhe Zhvillimi		2.027,68		2.027,68
	4 SME-të	37,46			37,46
	5 Trainimi	109,84			109,84
	6 Sporti	644,00			644,00
II	Ndihma sektoriale				1.115,25
	6 Transporti publik	440,00			440,00
	7 Shërbimet publike	450,00			450,00
	8 Minierat	30,00			30,00
	9 Energjia		195,25		195,25
	10 Televizionet/mediat			-	-
TOTALI		1.861,38	3.470,92	-	5.332,30

Të dhënat në tabelën nr. 6 tregojnë se instrumenti i përdorur më shumë është A1 - Subvencione dhe grante dhe instrumenti A2 - lehtësira tatimore, sikurse paraqitet edhe në grafiku nr. 7.

Grafiku nr. 7: Struktura e shpërndarjes të instrumenteve të ndihmës shtetërore për vitin 2014 në lekë dhe përqindje.





3. PËRMBLEDHJE

Raporti vjetor i monitorimit të ndihmës shtetërore për vitin 2014 është hartuar në përputhje me metodologjinë e Komisionit Evropian në fushën e raportimit të ndihmës shtetërore. Raporti vjetor për ndihmat shtetërore për vitin 2014 përfshin gjithashtu të dhëna për ndihmën në sektorin e bujqësisë dhe peshkimit, edhe pse ky sektor nuk bën pjesë në fushën e zbatimit të ligjit nr. 9374, datë 21.04.2005 “Për ndihmën shtetërore”. Ndihma shtetërore *përfshirë* sektorin e bujqësisë dhe peshkimit në vitin 2014 është dhënë në vlerën totale prej 6.503,12 mln lekë (46,41 mln euro). Ndihma shtetërore *përfshirë* sektorin e bujqësisë dhe të peshkimit në vitin 2014 është dhënë në vlerën totale prej 5.332,3 mln lekë (38 mln euro).

Ndihma shtetërore horizontale në vlerë absolute është 4.217,05 mln lekë (30,1 mln euro) dhe e krahasuar me vitin 2013 ka zbritur me 76 %. Pesha për këtë kategori në totalin e ndihmës në vitin 2014 ka zbritur me 24 % krahasuar me vitin 2013.

Ndihma shtetërore sektoriale në vlerë absolute është 1.115,25 mln lekë (9,96 mln euro), 2 % më pak krahasuar me vitin 2013. Pesha për këtë kategori në totalin e ndihmës në vitin 2014 është rritur në 17,15 % nga 5,65 % që ishte në vitin 2013.

Ndihma shtetërore për vitin 2014 karakterizohet nga një:

Rritje e ndihmës shtetërore për punësim, trajnim, ndihmën për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, të përfshira në kategorinë e ndihmës horizontale.

Instrumentet e përdorura më shumë janë: A1 - Subvencione dhe grante; dhe Instrumenti A2 - Përfshirje nga taksat, shtyrje e taksave, ulje e normës së taksave.

Strategjia e zhvillimit të biznesit dhe investimeve për vitet 2014-2020¹⁹, duhet theksuar se gjithashtu ka një ndjeshmëri të konsiderueshme në përmbushjen e objektivave të saj edhe ndaj rritjes së treguesve të ndihmës shtetërore. Drejtimit kryesorë të politikës për zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme gjatë periudhës 2014-2020, do të fokusohen në drejtim të përmirësimit të konkurrueshmërisë së SME-ve dhe inovacionit, përmirësimin e aksesit në financë të SME-ve, nxitjes së grave në biznes, mbështetjes së start-up

etj. Rritja në vitin 2014 e ndihmës për SME-të, ndihmës për trajnim dhe ndihmës për punësim reflektojnë fokusin e politikave nxitëse në fushën e biznesit, që synojnë marrjen parasysh të ndërvarësisë mes rritjes ekonomike, mirëqenies sociale dhe përdorimit eficient të burimeve shtetërore. Vlen të theksohet se rritja e ndihmave të sipërpërmendura ka përmirësuar më tej strukturën e ndihmës horizontale, duke arritur qëllimin për të cilin jepet ndihma shtetërore.

VENDIM

Nr. 473, datë 3.6.2015

**PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME
NË VENDIMIN NR. 276, DATË 1.4.2015, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
DHËNIEN NË PËRDORIM TË
PËRKOHSHËM, NGA MINISTRIA E
MBROJTJES MINISTRISË SË
ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT,
TREGTISË DHE SIPËRMARRJES DHE
MINISTRIT TË SHTETIT PËR
INOVACIONIN DHE ADMINISTRATËN
PUBLIKE, TË PRONËS NR. 33, ME
EMËRTIM “SHTËPIA E
USHTARAKËVE”, ME VENDNDODHJE
NË BULEVARDIN “ZHAN D’ARK”,
TIRANË, PËR VENDOSJEN E QENDRËS
KOMBËTARE TË REGJISTRIMIT (QKR),
QENDRËS KOMBËTARE TË
LICENCIMIT (QKL) DHE QENDRËS SË
OFRIMIT TË SHËRBIMEVE PUBLIKE
TË INTEGRUARA (ADISA)”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10 e 12, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 276, datë 1.4.2015, të Këshillit të Ministrave, bëhen shtesat dhe ndryshimi i mëposhtëm:

1. Në titull dhe në pikën 1 bëhen këto shtesa:

a) Pas emërimit “... ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike ...” shtohen fjalët “... si dhe ministrit të shtetit për Çështjet Vendore ...”.

¹⁹ Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 635, datë 1.10.2014

b) Pas emërimit “... Qendrës së Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA)” shtohen fjalët “... si dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Patentave dhe Markave (DPPM) e Agjencisë së Zbatimit të Reformës Territoriale (AZRT)”.

2. Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes t’i jepet, në përdorim të përkohshëm, trualli funksional i pronës, bodrumi, kati përdhes, kati i parë, i dytë, i tretë dhe i katërt i godinës, sipas planvendosjes dhe planimetrive, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij, për sistemimin e administratës së Qendrës Kombëtare të Regjistrimit (QKR), Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Patentave dhe Markave (DPPM). Ndarja e mjediseve të jetë, si më poshtë vijon:

a) Bodrumi të përdoret nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit (QKR), Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL), Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave (DPPM) dhe nga Qendra e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA).

b) Kati i parë dhe kati i tretë të përdoren nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit (QKR).

c) Kati i dytë të përdoret nga Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave (DPPM).

ç) Kati i katërt të përdoret nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL).”.

3. Pas pikës 2 shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:


“2/1. Ministrin të Shtetit për Çështjet Vendore t’i jepet në përdorim të përkohshëm kati i shtatë i godinës, sipas planimetrive dhe planvendosjes që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij, për sistemimin e administratës së Agjencisë së Zbatimit të Reformës Territoriale (AZRT).

Një pjesë e kësaj hapësire të katit të shtatë të përdoret nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit (QKR), Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL), Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave (DPPM), Qendra e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA) dhe Agjencia e Zbatimit të Reformës Territoriale (AZRT), si ambient i përbashkët për të zhvilluar takime dhe mbledhje pune.”.


Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Planimetri e katit nëntokë (QKR) - Sh. 1:175






07.04.201

Planimetri e katit **përdhe** (QKR + QKL) - Sh. 1:175*Planimetri e katit **të parë** (QKR) - Sh. 1:100



Planimetri e katit të dytë (QKR) - Sh. 1:100





VENDIM

Nr. 475, datë 3.6.2015

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 310, DATË 5.5.2010, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MËNYRËN DHE LLOGARITJEN E AFATEVE TË PAGIMIT TË ÇMIMIT TË TRUALLIT, PËR KALIMIN E SË DREJTËS SË PRONËSISË MBI TRUALLIN SHTETËROR, NË ZONAT ME PËRPARËSI TURIZMIN”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 10, të ligjit nr. 10186, datë 5.11.2009, “Për rregullimin e pronësisë mbi truallin shtetëror në zonat me përparësi turizmin”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 310, datë 5.5.2010, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Çmimi i truallit së njësisë së ndërtuar apo vlera e pjesës takuese paguhet në mënyrë të vetme, duke u reduktuar në masën 10 (dhjetë) për qind, nëse pagesa kryhet brenda 1 (një) muaji, nga

njoftimi me shkrim, në përputhje me përcaktimet e pikës 1, të nenit 14, të ligjit nr. 10186, datë 5.11.2009, “Për rregullimin e pronësisë mbi truallin shtetëror në zonat me përparësi turizmin”, të ndryshuar.”.

2. Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“4. Nëse pagesa e plotë apo e pjesës takuese të çmimit të truallit nuk kryhet brenda afatit të parashikuar në pikën 2, të këtij vendimi, në zbatim të pikës 2, të nenit 16, të ligjit nr. 10186, datë 5.11.2009, “Për rregullimin e pronësisë mbi truallin shtetëror në zonat me përparësi turizmin”, të ndryshuar, mbi vlerën e detyrimit llogaritet penalitet në masën 10 (dhjetë) për qind të çmimit total të truallit ose pjesës takuese, për çdo muaj vonesë, me kusht që masa e penalitetit të mos e kalojë këtë çmim, apo vlerën e pjesës takuese, sipas rastit.”.

3. Pika 6 shfuqizohet.

4. Në pikën 7 fjalët "...brenda afatit të përcaktuar..." shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

**VENDIM****Nr. 476, datë 3.6.2015**

**PËR MIRATIMIN, NË PARIM, TË
MARRËVESHJES, NDËRMJET
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE
TË GJERMANISË, PËR
BASHKËPUNIMIN FINANCIAR 2011 PËR
PROJEKTIN “EFICENCA ENERGJETIKE-
PROGRAMI PËR SEKTORIN E
TRANSMETIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 e 7, të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin, në parim, të marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar 2011 për projektin “Eficienca energjetike-programi për sektorin e transmetimit të energjisë elektrike”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI
Edi Rama**

MARRËVESHJE

**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË
GJERMANISË, MBI BASHKËPUNIM
FINANCIAR 2011 PËR PROJEKTIN
“EFICENCA ENERGJETIKE – PROGRAMI
PËR SEKTORIN E TRANSMETIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE”, KËSHILLI I
MINISTRAVE I REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE QEVERIA E
REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË**

Në frymën e marrëdhënieve miqësore ekzistuese ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë,

duke u nisur nga dëshira për t’i forcuar dhe thelluar këto marrëdhënie miqësore nëpërmjet Bashkëpunimit Financiar si partnerë;

të ndërgjegjshëm se ruajtja e këtyre marrëdhënieve përbën bazën e kësaj marrëveshjeje;

me qëllim për të kontribuar në zhvillimin social dhe ekonomik në Republikën e Shqipërisë;

duke iu referuar premtimit të ambasadës së Republikës Federale të Gjermanisë (nota verbale nr. 164/2011 e datës 21 shtator 2011);

ranë dakord si vijon:

Neni 1

1. Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë u jep mundësi Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë ose huamarrësve të tjerë, të cilët do të zgjidhen bashkërisht nga të dy Qeveritë, të marrin për projektin “Eficienca energjetike – Programi për sektorin e transmetimit të energjisë elektrike” një hua me kushte të favorshme nga Kreditanstalt für Wiederaufbau (KfW), e cila akordohet në kuadër të bashkëpunimit publik zhvillimor, me vlerë prej deri në 40.000.000 euro (me fjalë: dyzet milion euro), nëse pas shqyrtimit përkatës është konstatuar se projekti vlen për t’u mbështetur në kuadër të politikës zhvillimore dhe kur Republika e Shqipërisë vazhdon të jetë e besueshme lidhur me kreditë dhe kur Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë jep garanci shtetërore, në rast se ai vetë nuk është huamarrës. Projekti në fjalë nuk mund të zëvendësohet me projekte të tjera.

2. Në rast se Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë në një kohë të mëvonshme i jep mundësi Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë të marrë nga Kreditanstalt für Wiederaufbau hua ose shuma të tjera financimi për përgatitjen e projektit të përmendur në paragrafin 1 ose shuma të tjera financimi për masa të nevojshme shoqëruese për zbatimin dhe mbikëqyrjen e projektit të përmendur në paragrafin 1, gjen zbatim kjo marrëveshje.

3. Shumat e financimit për masa përgatitore dhe shoqëruese sipas paragrafit 2 do të kthehen në hua, në rast se ato nuk përdoren për masa të tilla.

Neni 2

1. Përdorimi i shumës së përmendur në nenin 1, kushtet me të cilat vihet në dispozicion ajo, si dhe procedura e dhënies së porosisë



përcaktohen në kontratat që do të lidhen midis Kreditanstalt für Wiederaufbau dhe marrësve të huave dhe të shumave të financimit, të cilat u nënshtrohen dispozitave ligjore në fuqi në Republikën Federale të Gjermanisë.

2. Premtimi i shumës së përmendur në nenin 1 bie, në rast se kontratat përkatëse të huadhënies nuk përfundohen brenda një afati prej tetë vjetësh pas vitit të premimit. Për shumën e përmendur në nenin 1, ky afat mbaron më datë 31 dhjetor 2019.

3. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, kur ai vetë nuk është huamarrës, do të garantojë ndaj Kreditanstalt für Wiederaufbau të gjitha pagesat me euro për shlyerjen e borxheve të huamarrësve në bazë të kontratave, të cilat do të do të lidhen sipas paragrafit 1.

4. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, në rastet kur ai vetë nuk është marrësi i shumave të financimit, do të garantojë ndaj Kreditanstalt für Wiederaufbau pretendimet eventuale lidhur me shlyerjen, që mund të lindin në bazë të kontratave për financim, të cilat do të përfundohen sipas paragrafit 1.

Neni 3

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë e liron Kreditanstalt für Wiederaufbau nga të gjitha tatimet dhe taksat e tjera publike, të cilat merren në Republikën e Shqipërisë në kontekstin e lidhjes dhe zbatimit të kontratave të përmendura në nenin 2 paragraf 1.

Neni 4

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i lejon pasagjerët dhe furnizuesit të zgjedhin lirisht ndërmarrjet transportuese për transportimin e personave dhe të mallrave në rrugë detare, tokësore dhe ajrore, që rezulton nga dhënia e shumës së financimit, si dhe nuk merr asnjë masë e cila përjashton ose vështirëson pjesëmarrjen me të drejta të barabarta të ndërmarrjeve transportuese me qendër në Republikën Federale të Gjermanisë, dhe nxjerr në rast se duhet lejet e nevojshme për pjesëmarrjen e këtyre ndërmarrjeve transportuese.

Neni 5

1. Kjo marrëveshje hyn në fuqi në ditën kur Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i njofton Qeverisë së Republikës Federale të

Gjermanisë se janë përmbushur kushtet brenda-shtetërore për hyrjen e saj në fuqi. Përcaktuese është dita e marrjes së njoftimit.

2. Regjistrimi i kësaj marrëveshjeje te sekretariati i Kombeve të Bashkuara, sipas nenit 102 të Kartës së Kombeve të Bashkuara, do të iniciohet nga Republika Federale e Gjermanisë, menjëherë pas hyrjes së saj në fuqi. Pala tjetër kontraktuese do të njoftohet për regjistrimin e kryer, duke u dhënë numrin e regjistrimit të Kombeve të Bashkuara, sapo ky të jetë i konfirmuar nga sekretariati i Kombeve të Bashkuara.

Bërë në Tiranë më në dy origjinale, secili në gjuhën shqipe dhe gjermane, duke pasur të dy tekstet fuqi të barabartë.

VENDIM

Nr. 477, datë 3.6.2015

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES
SHITESË TË KONCESIONIT “PËR DISA
NDRYSHIME NË MARRËVESHJEN E
KONCESIONIT TË FORMËS “BOO”,
NDËRMJET MINISTRISË SË
INDUSTRISË DHE ENERGJETIKËS
DHE SHOQËRISË “TEODORI”, SHPK.,
TIRANË, PËR NDËRTIMIN E
HIDROCENTRALEVE NË TËRNOVË
DHE NË ZALL TË BULQIZËS”,
MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 556,
DATË 1.8.2003, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 50, të ligjit nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e marrëveshjes shtesë të koncesionit “Për disa ndryshime në marrëveshjen e koncesionit të formës “BOO”, ndërmjet Ministrisë së Industrisë dhe Energjetikës dhe shoqërisë “Teodori”, sh.p.k., Tiranë, për ndërtimin e hidrocentraleve në Tërnovë dhe në Zall të Bulqizës”, miratuar me vendimin nr. 556, datë 1.8.2003, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.



2. Në vendimin nr. 556, datë 1.8.2003, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, dhe në tekstin e marrëveshjes bazë të koncesionit, emërtimi “Ministria e Industrisë dhe Energjetikës” zëvendësohet me “Ministria e Energjisë dhe Industrisë”.

3. Ngarkohet Ministria e Energjisë dhe Industrisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

REPUBLIKA E SHQIPERISË
ZYRA E NOTERISË TIRANË
NR. 324/ Rep.
NR. 59 Kol.



KONTRATE SHITESË KONCESIONI

PER

PËR DISA NDRYSHIME NË MARRËVESHJEN E KONCESIONIT TË FORMËS “BOO” NDËRMJET MINISTRISË SË INDUSTRIËS DHE ENERGJETIKËS DHE SHOQËRISË “TEODORI” SH.P.K. TIRANË, PËR NDËRTIMIN E HIDROCENTRALEVE NË TERNOVE DHE NË ZALL TË BULQIZES, MIRATUAR ME VENDIMIN NR.556, DATË 01.08.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, I NDRYSHUAR

Në Tiranë, më datë 03 muaji Prill, viti 2015 (dymijë e pesëmbëdhjetë), para meje noter Ministria e Energjisë dhe Industrisë anëtar i dhomës së Noterisë Prill, me adresë Dr. Bogdan, u paraqitën palët kontraktuese si më poshtë:

Ministria e Energjisë dhe Industrisë, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, përfaqësuar nga Z.Koli Bele i datëlindjes 24.01.1975, madhor dhe me zotësi juridike për të vepruar, për identitetin e të cilës u sigurova nga pasaporta H 50124103U

DHE

Koncesionari, Shoqëria “Teodori” sh.p.k. me seli ne Tirane, ne adresën: “Rr. Niko Avrami” shtepi private prane pallatit nr. 17, e përfaqësuar nga administratori i saj Z. Faik Teodori, i datëlindjes 16.06.1954, madhor dhe me zotësi te plote juridike e për te vepruar, per indetitetin e te cilit u sigurova nga ID Nr. 024608715.

Palët të cilët me vullnetin e tyre të lirë, bien dakord si më poshtë:

Të lidhin këtë kontrate shtesë koncesioni, si pjesë përbërëse e Kontratës bazë të Koncesionit të formës “BOO”, të nënshkruar nga palët Ministria e Industrisë dhe Energjetikës dhe Koncesionarit “Teodori” sh.p.k., “Për ndërtimin e hidrocentraleve “Ternove” dhe “Zalli i Bulqizes” miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 556, date 01.08.2003, i ndryshuar me VKM nr.123, date 14.03.2007, dhe me kontratat shtese Nr.166Rep., Nr.94 Kol., dt 15.01.2003 dhe nr.404Rep., Nr.219 Kol., dt.22.07.2014.



Hyrje

Duke pasur parasysh që:

Qeveria e Shqipërisë

Synon aplikimin e strategjive afatgjata dhe efikase për sistemin elektro-energjistik të Shqipërisë, me qëllim krijimin e një Sistemi Elektroenergjetik të qëndrueshëm operacionalisht, teknikisht dhe financiarisht, të aftë për të plotësuar kërkesën në rritje për energji elektrike brenda vendit duke e shndërruar Shqipërinë nga vend importues i energjisë elektrike, në vend eksportues të saj.

Si dhe:

- Kërkeses që koncesionari “Teodori” Sh.P.K., me ane të shkresës nr.5017/3, datë 25.03.2015, ka depozituar pranë Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, “Për ndryshimin e nenit 11 “Kufizimi i koncesionit”, të kontratës baze të koncesionit gje që do të lejonte koncesionarin që pas miratimit nga OSHA, të kryejë transferimin pjesërisht apo tërësisht të të drejtave dhe detyrimeve të marra përsipër prej tij me këtë kontratë. Ky ndryshim synon të rrisë autonomine e shoqërisë, duke zbatuar parimin e kalimit të lirë të kuotave sikurse parashikohet dhe në legjislacionin aktual “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” gje që con në rritjen e cilësisë, efikasitetit të hidrocentraleve, optimizimin e produktivitetit të tyre dhe menaxhimi sa më i mirë i burimeve kapitale dhe njerëzore të shoqërisë.
- Nenit 48, të ligjit nr.125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat” i ndryshuar, nenit 35 të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, i ndryshuar, Ligjit nr.9901, dt.14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”

Ministria e Energjisë dhe Industrisë në cilësinë e OSHA me qëllim rritjen e autonomise së shoqërisë koncesionare, për rritjen e efektivitetit në administrimin e hidrocentraleve, rritjen e cilësisë, efikasitetit të hidrocentraleve, optimizimin e produktivitetit të tyre dhe menaxhimit sa më të mirë të burimeve kapitale dhe njerëzore të shoqërisë, e ka gjykuar si të arsyeshme aprovimin e kërkesës së shoqërisë koncesionare për ndryshimin e nenit 11 të kontratës baze

Për këto arsye,

Palet bien dakord që në Kontratën baze të Koncesionit të formës B.O.O. “Për ndërtimin e hidrocentraleve “Ternove” dhe “Zalli i Bulqizes””, të bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në Kontratën baze të Koncesionit të formës B.O.O. “Për ndërtimin e hidrocentraleve “Ternove” dhe “Zalli i Bulqizes”, përcaktimin e Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë si OSHA, pra pas titullit, tek paragrafi i parë i Marrëveshjes fjalët: “..e përfaqësuar nga Ministria e Industrisë dhe



Energjetikës”, të zëvendësohen me fjalët: “..e përfaqësuar nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë”.

Neni 2

Neni 1 i “Kufizimi i koncesionit”, ndryshohet si me poshtë vijon:

Për çdo transferim të aksioneve/të kapitalit themeltar të shoqërisë koncesionare tek të tretët koncesionari ose shoqëria koncesionare duhet të marrë pëlqimin paraprak të OSHA.

Koncesionari nuk ka të drejtë të transferojë pjesërisht apo tërësisht të drejtat dhe detyrimet e marra përsipër me këtë kontratë, përveçse kur një transferim i tillë miratohet me shkrim nga OSHA.

Neni 3

Kjo kontratë shtese, hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga palët, në përputhje me ligjin nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet” i ndryshuar, dhe pas miratimit të saj nga Këshilli i Ministrave.

Kjo marrëveshje u hartua në 6 (gjashtë) kopje dhe pasi ju lexua palëve, të cilët e kuptuan dhe e pranuan atë, e nënshkruan me vullnet të lire e të plotë, dhe une noterje e vërtetoj atë rregullisht.

AUTORITETI KONTRAKTUES

Ministria e ENERGJISE DHE INDUSTRIE

Përfaqësuar me Autorizimin Nr. 31/14,

date 02/06/2015 te Ministrit te

te Energjise dhe Industrise

z. Koli BECE



KONÇESIONARI

“TEODORI” shpk

Administratori

z. Faik TEODORI



**VENDIM****Nr. 478, datë 3.6.2015**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR. 1086, DATË 14.12.2013, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
KRIJIMIN E TASK-FORCËS PËR
PËRMIRËSIMIN E NIVELIT TË
ARKËTIMEVE DHE ULJEN E NIVELIT
TË HUMBJEVE NË SISTEMIN E
SHPËRNDARJES SË ENERGJISË
ELEKTRIKE”**

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 100, të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në pikën 6, të vendimit nr. 1086, datë 14.12.2013, të Këshillit të Ministrave, fjalët “... deri më 30 qershor 2015...” zëvendësohen me “... deri më 30 qershor 2016 ...”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Edi Rama**

VENDIM**Nr. 479, datë 3.6.2015**

**PËR FINANCIMIN E URDHËRIT TË
STOMATOLOGUT TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË PËR NJË PERIUDHË
NJËVJEÇARE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të ligjit nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, dhe të nenit 19, të ligjit nr. 127/2014, “Për Urdhërin e Stomatologut në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Financimin e Urdhërit të Stomatologut të Republikës së Shqipërisë për një periudhë njëvjeçare, në masën 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë.

2. Ky fond të përballohet nga buxheti i vitit 2015, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë për programin “Shëndeti publik”.

3. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Edi Rama**

VENDIM**Nr. 481, datë 3.6.2015**

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË
PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI
I SEGMENTIT RRUGOR “KALIMASH -
MORINË”(SHITESAT)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Kalimash - Morinë” (shitesat).

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë “arë”, “truall” dhe “objekte”, me vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 26 387 209 (njëzet e gjashtë milionë e treqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e nëntë) lekësh, nga të cilat:

a) tokë “arë”, me sipërfaqe 48 980 (dyzet e tetë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë) m², me vlerë shpronësimi 8 917 104 (tetë milionë e nëntëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e njëqind e katër) lekë;

b) tokë “truall”, me sipërfaqe 830 (tetëqind e tridhjetë) m², me vlerë shpronësimi 167 660 (njëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë) lekë;

c) objekte, me vlerë shpronësimi 17 302 445 (shtatëmbëdhjetë milionë e treqind e dy mijë e katërqind e dyzet e pesë) lekë.



4. Vlera përgjithshme e shpronësimit, prej 26 387 209 (njëzet e gjashtë milionë e treqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e nëntë) lekësh, të përballohet nga buxheti i vitit 2015, miratuar për Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës, zëri “Shpronësime”, planifikuar për Autoritetin Rrugor Shqiptar.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

6. Shpronësimi të fillojë pas çeljes së fondit të përcaktuar në pikën 4, të këtij vendimi.

7. Pronarët e përmendur në listën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZVRPP”, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar.

8. Autoriteti Rrugor Shqiptar të kryejë likuidimet, për efekt shpronësimi, në bazë të pikave 4, 5, 6 dhe 7, të këtij vendimi.

9. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Kukës, në bashkëpunim me Autoritetin Rrugor Shqiptar, brenda 30 ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, të fillojnë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës mbi hartat kadastrale, sipas planimetrisë së

shpronësimit që do t'u vihet në dispozicion nga Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe, me fillimin e procesit të likuidimit, të bëjnë kalimin e pronësisë, për pasuritë e shpronësuara, në favor të shtetit.

10. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Kukës të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohet procesi i hedhjes së trupit të rrugës mbi hartat kadastrale dhe kalimi i pronësisë, për pasuritë e shpronësuara.

11. Ngarkohen Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Ministria e Financave, Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Kukës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
SEKTORI SHPRONËSIMEVE

Tabela 1

LISTA E PRONAREVE QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË NDËRTIMIT TË SEGMENTIT RRUGOR
"KALIMASH -MORINE" (SHTESA, OBJEKTE NDËRTIMI)

Nr.	Pronari			Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Vlera në lekë sipas preventivit	Lloji i pasurisë	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri					
1	Hajdin	Dan	Istrefi	1543	192/11	2199068	Shtëpi banimi	Konfirmuar nga ZVRPP
2	Sulejman	Dan	Istrefi	1543	192/5	2039220	Shtëpi banimi	Konfirmuar nga ZVRPP
3	Man	Istref	Istrefi	1543	192/6+192/10	5174208	Shtëpi banimi	Konfirmuar nga ZVRPP
4	Petrit	Rasim	Oruçi	1543	211/2	1501993	Shtëpi banimi	Konfirmuar nga ZVRPP
5	Ylber		Voka	2315	31/1(31/2)	2030118	Shtëpi banimi	Konfirmuar nga ZVRPP
6	Qemal	Sinan	Mehmetaj	1543	188/2	4357838	Shtëpi banimi	Konfirmuar nga ZVRPP
		TOTALI				17302445		



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TRANSPORTIT
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
SEKTORI SHPRONËSIMEVE

Tabela 2

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË NDËRTIMIT TË SEGMENTIT RRUGOR
"KALIMASH -MORINE" (SHTESA, PËR PASURI, ARË, TRUALL)

Nr	Pronari			Z. K	Nr. Pas.	Truall			Arë			Vlera totale lekë	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri			Sip. m ²	Çmimi m ²	Vlera në lekë	Sip. m ²	Çmimi m ²	Vlera në lekë		
1	Fatmir	Hamdi	Shehu	3425	106/10				11128	182	2025296	2025296	Konfirmuar nga ZVRPP
2	Ilmi	Avdi	Shehu	3425	96/2/1				3964	182	721448	721448	Konfirmuar nga ZVRPP
3	Mus	Mustaf	Shehu	3425	96/1				10277	182	1870414	1870414	Konfirmuar nga ZVRPP
4	Fadil	Mustaf	Shehu	3425	96/3/1				8316	182	1513512	1513512	Konfirmuar nga ZVRPP
5	Sokol	Fetah	Shehu	3425	96/4/1				8136	182	1480752	1480752	Konfirmuar nga ZVRPP
6	Mustaf	Mus	Shehu	3425	97/1/2				5062	182	921284	921284	Konfirmuar nga ZVRPP
7	Selam	Faik	Shehu	3425	97/1/3				1411	182	256802	256802	Konfirmuar nga ZVRPP
8	Dashmir	Zelfi	Todaj	2208	131/1				686	186	127596	127596	Konfirmuar nga ZVRPP
9	Hamdi	Ajet	Oruci	1543	165/7	830	202	167660				167660	Konfirmuar nga ZVRPP
	TOTALI					830		167660	48980		8917104	9084764	

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2015

Adresa
Bulevardi “Gjergj Fishta”,
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”,
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 280 lekë